Mirëmbajtja e sistemit teknik të kondicionimit, përfshin, përveçse përmirësimin e performancës energjitike të projektuar dhe të zbatuar, por edhe vendosjen e kriterëve dhe protokolleve teknike të cilat sigurojnë eficiencë të lartë, siguri shëndetësore (COVID 19), e cila klasifikohet si element thelbësor e lidhur ngushtë me mirëmbajtjen e ndërtesës historike.

Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar në Kryeministri, është një *sistem qendror* i përbërë nga makinat dhe pajisjet e mëposhtme të cilat kanë fuqinë e instaluar 409.6kW – ngrohje dhe 309.6kW – ftohje.

Makinat termike që mbajnë këtë ngarkesë janë objekt i mirëmbajtjes sipas kateve, përfshirë zyrën kryesore të Kryeministrit:

KATI 0 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin – në total 6 sisteme me 12 njësi të jashtme dhe 79 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 33,5-37,5 kW 6 copë dhe 45,0-50,0 kW 6 copë.
- Njësi të brendshme kasete 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kW 75 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kW 4 copë.

KATI +1 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin – në total 9 sisteme me 14 njësi të jashtme dhe 87 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 28.0-33,5-37,5 kW 5 copë, 45,0-50,0 kW 8 copë dhe 56.0-63.0 1 copë.
- Njësi të brendshme kasete 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kW 77 copë.
- Njësi të brendshme kasete 7.1-8.0 kW 5 copë.

- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kW 5 copë.

KATI +2 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin – në total 7 sisteme me 13 njësi të jashtme dhe 91 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 28.0-33,5-37,5 kW 5 copë, 45,0-50,0 kW 8 copë dhe 56.0-63.0 1 copë.
- Njësi të brendshme kasete 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kW 71 copë.
- Njësi të brendshme kasete 7.1-8.0 kW 8 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kW 2 copë.

Kryeministria ndërtesa qëndrore

KATI 0, +1, +2 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (Toshiba) – në total 3 sisteme me 7 njësi të jashtme dhe 9 njësi të brendshme kanalore dhe 15 rikuperatorë energjie nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 20.0-23,5, 13.4-15.5, kW 7 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kW 5 copë.
- Njësi të brendshme incasso 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kW 4 copë.
- Rikuperatorë energjie ajrues 15 njësi.

Software dhe hardware: 4 njësi sëbashku me LAN.

Qëllimi i mirëmbajtjes

Qëllimi i mirëmbajtjes është që sistemi i kondicionimit të jetë totalisht në punë gjatë 24 orëve. Gjithashtu, sistemi i kondicionimit duhet të sigurojë rregullimin e temperaturës dhe të sasive të projektuara dhe të realizuara të ajrit të freskët në mjediset e brendshme ashtu siç është projektuar. Ajri i freskët përmes rikuperatorëve të energjisë do të sigurohet që të fusë minimalisht rreth 25% ajër të freskët, i cili përpunohet në të gjithë ndërtesën së bashku me ajrin riqarkullues. Kjo situatë kërkon që njësitë me rikuperim nxehtësie, përveçse të sigurojnë që të ruajnë 50-60% temperaturën (nxehtësinë) e ajrit të brendshëm, i cili del nga rikuperatori, por duhet të bëjnë ndryshimin (ose pastrimin) e filtrave në kontakt me ajrin e jashtëm, të paktën një herë në javë për 52 javë të vitit. Kështu, ajri që do të ri-qarkullojë në mjediset e ndërtesës nëpërmjet kanaleve të ajrit është e domosdoshme të përshkojnë sistemin e rikuperimit të Energjisë për të ndryshuar parametrat termike, që janë temperatura dhe lagështia.

Mirëmbajtja dhe sjellja termike e ndërtesës.

Kryeministria (kati “0”, “+1” dhe “+2”), është një ndërtesë e konstruktuar në vitet 1924-1928, e tipit italian dhe me inerci të lartë termike. Si karakteristikë termike kjo ndërtesë ofron muraturë të rëndë dhe një raport shumë komod mes dritareve dhe mureve rrethuese. Kjo gjë bën të mundur ruajtjen e nxehtësisë së të ngrohtit dhe të ftohtit në parametra maksimale (krahasuar me ndërtesat e “lehta” në Tiranë).

Koeficienti i masivitetit 0.75, që do të thotë raporti mes volumit të okupuar dhe volumit të matur nga jashtë ndërtesës është i konsiderueshëm. Pra, 25% e volumit të ndërtesës është muraturë, e cila me ngrohjen dhe/ose freskimin e saj “ngarkohet” kthehet pas një farë kohe në një burim nxehtësie që reflekton gjatë kohës kur impianti është në qetësi dhe/ose në rastet kur nuk funksionon për ndonjë arsye. Kjo situatë është një faktor arkitektonik dhe konstruktiv mjaft pozitiv dhe e ndihmon punën e sistemit.

Me këtë rast mund të themi se koha minimale për të “lejuar” ndërtesën në tërësi pa trajtim me kondicionim është rreth 3-6 orë, kohë gjatë së cilës duhet të reagojë skuadra e mirëmbajtjes për

të riparuar një defekt të mundshëm në njësitë e brendshme dhe të jashtme. Kështu nga analiza e bërë rezulton se:

- Koha më e shkurtër në dispozicion të riparimit të njësive të brendshme është 3 orë.
- Koha më e shkurtër në dispozicion të riparimit të njësive të jashtme është 6 orë.

Si konkluzion:

- Njësia e brendshme e tipit kasetë mund të riparohet për:
 - o 30 minuta për ndryshim filtri ajri
 - o 1 orë për ndryshim të pompës së kondensatit
 - o 2 orë për ndryshim të paketës elektronike të marrjes së komandave wireless
 - o 3 orë për t'u zëvendësuar me një të re.
- Njësia e brendshme e tipit kanalor
 - o 30 minuta për ndryshim filtri ajri
 - o 1.5 orë për ndryshim të pompës së kondensatit
 - o 2.5 orë për ndryshim të paketës elektronike të marrjes së komandave wireless
 - o 4 orë për tu zëvendësuar.
 - o 0,5 deri 1 orë për të vendosur mbulesën me karton-gips së bashku me shpatullimin, dhe 0,5 orë për lyerjen e gipsit
- Rikuperatori i ajrit
 - o 30 minuta ndryshimi i filtrit të brendshëm dhe të jashtëm
 - o 2 orë ndryshimi i pompës së kondensatit
 - o 2.5 orë ndryshimi i komanduesit elektronik
 - o 4 orë për të ndryshuar këmbyesin ajër-ajër
 - o 4 orë për të ndryshuar mbulesën prej gipsi
 - o 2 orë vendosja dhe lyerja e karton-gipsit

Domosdoshmëria e mirëmbajtjes. Parimet e sigurisë të shëndetit.

Sistemi i Kondicionimit është i lidhur ngushtë me ngarkesat termike për ngrohje/ftohjen e Kryeministrisë, ngarkesë e cila jepet për të dy periudhat (Ngrohe/Ftohe) përmes impiantit të Sistemit të Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar për punë të vazhduar 350 ditë dhe 24/7 orë. Impianti domosdoshmërisht qëndron në gjendje pune përgjatë vitit dhe duhet të jetë në gatishmëri për 8400 orë dhe për arsye shërbimi kërkohen që ai të ndalohej të paktën 65 orë. Kështu rreth 360 nga 365 ditë të vitit (totali vjetor është 8760 orë/vit) kërkohet shërbim i thelluar 15 ditë të vitit për pjesë të veçanta të sistemit.

Nisur nga siguria për shëndetin e zyrtarëve të shërbimit civil dhe funksionit të rëndësisë së veçantë që përfaqëson ndërtesa e Kryeministrisë parimet e mirëmbajtjes janë:

- Parimi i shëndetit në përgjithësi dhe në kushtet e COVID-19.
- Parimi i komfortit termik të temperaturës sipas kërkesave minimale të performancës.

- Parimi i sigurisë në punë duke larguar me ajrin të gjitha elementët e dëmshëm për shëndetin dhe aromat nga pajisjet elektronike, printerat, fotokopjet, mobiljet, mbetjet, avullimet, frymëmarrjet njerëzore, ushqimet, etj.
- Parimi i vazhdueshmërisë së punës së impiantit për 350 ditë dhe 24/7 orë.
- Parimi i reagimit të skuadrës së mirëmbajtjes në kohën e përcaktuar në paragrafin më lart.

Kufijtë e brendshëm të komfortit pas mirëmbajtjes

<i>Temperaturat</i>	<i>Dimër</i>	<i>Verë</i>
Në Zyra	20 ± 1°C	25 ± 1°C
Në Salla Pritje	21 ± 1°C	23 ± 1°C
Në Salla Mbledhje	23 ± 1°C	23 ± 1°C
Në Korridore	20 ± 1°C	25 ± 1°C
Lagështia relative	30-40%	60%

<i>Niveli i zhurmave</i>	<i>kriteri i zhurmave</i>
I krijuar nga pajisjet e ndërtesës	NC 45 (Noise Criteria)
Në Zyra	NC 35
Në Salla Pritje	NC 35
Në Salla Mbledhje	NC 35

Sasitë e ajrit ventilues

Zyra	5 l/s për person ajër i freskët
Tualete	12 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)
Salla Mbledhje	2 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)
Korridore	2 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)
Qarkullimi i brendshëm	2.0 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)

SISTEMI VRV DHE LËVIZJA E AJRIT NË KANALE

Cilësia e kërkuar për materialet e vendosura për mirëmbajtjen.

Punimet që do të kontraktohen për mirëmbajtjen duhet të përfshijnë, furnizimin me pjesë ndërrimi, makineritë ngritëse, testimin, balancimin si dhe vendosjen për punë të sistemit të ajrit të kondicionuar si një i tërë. Është detyrë e kontraktorit të mirëmbajtjes, zgjedhja e pajisjeve mbështetëse të tilla që mundësojnë realizimin e procesit të mirëmbajtjes dhe përzgjedhjes së “skuadrës së mirëmbajtjes” të aftë për të kuptuar dhe realizuar proceset e mirëmbajtjes të parashikuara në këtë raport.

Në specifikimet teknike të makinave të sistemit me ajër të Kondicionuar, instruksionet e mirëmbajtjes është e domosdoshme të respektohen duke ndjekur protokollin e parashikuar në to. Inxhinieri i zbatimit të mirëmbajtjes duhet të vendosë për pjesë ndërrimi dhe materiale të certifikuar dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve.

Sistemi i kanaleve të ajrit

Nëse nuk ndryshohen, të gjithë kanalet e ajrit duhet të mirëmbahen në përputhje me vizatimet “as build” të zhvilluar nga kontraktori zhvillues i sistemit të kanaleve të ajrit. Kjo me qëllim për të hyrë nëpërmjet portave të lejuara nga specifikimet teknike të sistemit të qarkullimit të ajrit. Në çdo rast standardet përkatëse EN dhe DIN janë të detyrueshme. Pas mirëmbajtjes kanalet e ajrit duhet të jenë të lëmuar nga brenda, nuk duhet të kenë verbime nën të gjitha kushtet e punës dhe pa humbje presioni.

Testimi i kanaleve të ajrit

Pas procesit të mirëmbajtjes, të gjitha kanalet e ajrit (furnizimi dhe kthimi) duhet të testohen dhe të jenë hermetike në mënyrë të tillë që i gjithë sistemi, duke përfshirë edhe lidhjet fleksibël me njësitë fundore të ajrit të mos kenë rrjedhje më shumë se 4% të sasisë maksimale të projektuar të ajrit në presionin statik në kushtet e punës të kanalit të ajrit.

Mirëmbajtja e filtrave të ajrit

Mirëmbajta parashikon zëvendësimin e filtrave të thatë të ajrit të pastrueshëm me solucione. Në qoftë se pas pastrimit filtri dëmtohet ai duhet të zëvendësohet. Pas pastrimit filtri duhet të puthitet plotësisht në skeletin mbajtës dhe nuk duhet të lejojë kalime të ajrit anash tij. Filtrat duhet të jenë të lëvizshëm nga ana e sipërme e rrjedhjes së ajrit në mënyrë që drejtimi i presionit të ajrit të veprojë kundër guarnicioneve.

SISTEMI OPSIONAL I MENAXHIMIT TË NDËRTESES (BMS)

Parametra të përgjithshëm që duhet të mirëmbahen.

Sistemi menaxhues MUND të instalohet në dhomën kryesore të sigurisë, bordi shpërndarës me të gjithë kontrollat dhe pajisjet I/O, do të instalohet në dhomat e shërbimit të ndërtesës. Çdo pajisje kontrolli do të punojë për veten pa kontroll të mëtejshëm të ushtruar nga të tjerët apo nga sistemi menaxhues. Sistemi menaxhues kontrollon komunikimin midis pajisjeve të kontrollit, ndryshon parametrat dhe shfaq të gjithë inputet.

Parametra kryesore të sistemit do të jenë:

- Sistemi është pjesë e një kontrolli digjital me pajisje autonome.
- Në sistemin BMS përfshihen prodhimi i nxehtësisë dhe shpërndarja, prodhimi i të ftohtit dhe shpërndarja, sistemi i ventilimit, pajisjet e sistemit kundër zjarrit (monitorimi i damperëve të zjarrit), punët elektrike (monitorimi) dhe ngritjet (monitorimi dhe alarmet e brendshme).
- Aparatet matëse të Ngrohjes, Ventilimit dhe të Kondicionimit të Ajrit (HVAC) dhe impiantet elektrike do të monitorohen dhe do të ruhen.
- Një sistem emergjence me anë të kontrollit manual në nivel programi për sistemet e HVAC-se duhet të jetë aktiv.
- Kërkohej paraqitje e lehtë dhe informacion i përditësuar (i kohës me të fundit) për të gjitha ngjarjet. Funksionim i lehtë si rezultat i përdorimit të dritareve dhe menuve minimizuese.
- Të gjitha karakteristikat e funksionimit do të jenë me vetëshpjegim, pa qenë e nevojshme për njohuri të veçanta në shërbimet IT, në të dy gjuhët, në anglisht dhe në shqip (gjuha zgjidhet me anë të një butoni në ekran).
- Funksionim me password (fjalëkalim) për nivele të ndryshme (të paktën tre – Admin, Teknik dhe Survejim)

ZONA EIB

Zona bi-direksionale me një portë në nivelin e fushës përfshin:

Nga EIB / KONNEX në BMS

- Temperaturën aktuale të dhomës
- Temperaturën nominale të dhomës
- Alarmi i pikës së vesës
- Kërkesë për ngrohje
- Kërkesë për ftohje
- Ndryshimi i temperaturës së furnizimit të ngrohjes ose ftohjes
- Të dhënat e matura

Nga BMS ne EIB / KONNEX

- Datën dhe orën
- Kontrollin e ndriçimit
- Temperaturën e jashtme
- Optimizmin e kohës së punës si rezultat i startimit të vonë dhe ndalimit të shpejtë, i ngrohjes dhe ftohjes.

Të gjithë këto të dhëna nga EIB / KONNEX do të paraqiten (në grafikë të ndarë) por nuk do të ruhen.

SISTEMI I VENTILIMIT

Funksionimi starton me kronometër të programuar. Parametrat individual për çdo impiant duhet të jenë të përcaktuara. Është i mundur kontrolli për ftohjen e lirë gjatë natës. Limitet nominale duhet të përcaktohen në mënyrë të veçantë për çdo funksionim dhe impiant.

I gjithë sistemi i ventilimit duhet të mbyllet në rast zjarri në dhomën e impiantit ose në zonat e okupuara ku zjarri do të zbulohet nga sistemi i zbulimit të zjarrit.

Ventilatorët

Motori i ventilatorit do të kontrollohet nga mbrojtja e mbingarkesave. Funksionimi si dhe rastet e defekteve do të përfshihen në kontrollin automatik të pajisjes me drejtimin për në derën e panelit. Për të gjithë motorët që punojnë me rripa transmisioni V, duhet të instalohet kontrolli i rripit V. Në raste të shkëputjes së rripit të transmisionit, impianti do të dale jashtë pune, dhe do të bjerë alarmi në sistemin e menaxhimit dhe tek teknikët me anë të modemit SMS. Furnizimi me energji elektrike i motorëve të ventilatorëve duhet të ndërpritet me anë të çelësit kryesor (i mbyllur), i pozicionuar në kasën e motorit ose në afërsi të tij.

Njësitë e Brendshme – kontrolli në dhoma

Të gjitha zyrat dhe sallat do të kontrollohen nga EIB / Konnex me disa kontrolle në dhoma të FCU (fan-coil). Sistemi i fan-coil-ave do të jetë një sistem me 3 tuba. Valvola kryesore që ndryshon proceset nga ngrohje në ftohje, do të drejtohet nga BMS sipas kërkesave, temperaturës së jashtme dhe kohëmatësit vjetor.

Valvola e njësisë fan-coil do të jetë e tipit elektrotermostatike, me 230 V për lidhje me EIB / Konnex. Kjo pajisje mund të rregullojë vlerën nominale të temperaturës me $\pm 5^{\circ}\text{C}$. Vetë kjo vlerë varet nga temperatura e jashtme dhe nga kapaciteti ftohës i pajisjes së jashtme. Kjo do të regjistrohet vazhdimisht. Shpejtësia e ventilatorit të njësisë fan-coil mund të zgjidhet në tre shkallë.

Zonat e takimit me sistemet e tjerë

Për njësinë e jashtme dhe EIB / Konnex do të jetë një portë me zonë bi dreksionale, për të gjithë të tjerët do të ketë një kontakt të thatë (një për çdo impiant sipas specifikimeve teknike).

Aparatet matës të energjisë

Konsumi i energjisë elektrike brenda ndërtesës nga departamente të ndryshëm, do të matet. Këto të dhëna do të transmetohen në BMS. Përpara transmetimit të të dhënave, duhet të ketë një ndryshim nga impulse në gjuhën e të dhënave me qëllim shmangien e humbjeve të impulseve dhe ruajtjen e të dhënave të gabuara. Programi i BMS duhet të mundësojë rregullime të vendosura nga personeli si të regjistruara për çdo muaj dhe të transmetuara në një sistem menaxhimi për inventarin e të dhënave historike të menaxhueshme.

PARASHIKIME TË PROJEKTIT TEKNIK

DETYRA E PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit duhet të përmbajë këto elemente kryesore dhe realizohet nga ekipi i menaxhimit të projektit:

- Të dhëna të përgjithshme të projektit dhe vendin e projektimit
- Qëllimi i projektit dhe zgjedhja e sistemit sipas kësaj Projekt ideje
- Detyrat që do të zgjidhë projekti
- Vendosja e një sistemi teknik eficient
- Llogaritje për saktësinë e fuqisë së instaluar të sistemit të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit.
- Vlerësimi i ngarkesës termike në dy sezona. Skema e zgjedhur dhe zgjidhja në projekt.
- Parametrat e projektimit për komfortin. Kushtet e brendshme projektuese.
- Temperatura projektuese. Niveli maksimal i lejueshëm në zgjedhjen e pajisjeve.
- Kontrolli për sasitë e ajrit ventilues.
- Zëvendësimi i sistemeve mekanike dhe hidraulike
- Rinovimi i sistemit elektrik të furnizimit të pajisjeve të jashtme dhe të brendshme
- Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi
- Paraqitja grafike e projektit, numri i fletëve dhe relacioni shoqërues
- Raportimi në autoritetin kontraktor
- Grafiku i lëvrimit të projektit
- Fondi limit i projektit të zbatimit dhe kushte për zbatimin.
- Kriteret e kapaciteteve profesionale të operatorit ekonomik.

Menaxhimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes të sistemit VRV në ndërtesën e Kryeministrisë

Kërkesat bazë të “Skuadrës së Mirëmbajtjes”

Sistemi VRV në ndërtesën e Kryeministrisë është praktikisht i teknologjisë më të fundit të viteve 2018-2019 dhe si e tillë kërkon një program të përgjithshëm menaxhimi me qëllim që të trajtojë organizimin, organikën, planifikimin dhe kontrollin e funksionimit dhe mirëmbajtjes.

Mirëmbajtja e sistemit teknik të sistemit VRV është përgjegjësi e një personeli teknik të trajnuar për teknologjinë e ngrohje/ftohjes dhe që përfaqëson skuadër të kualifikuar dhe të trajnuar. Si e tillë “Skuadra e Mirëmbajtjes” duhet të ketë të garantuar se trajnimet për mirëmbajtjen dhe operimin e këtyre pajisjeve nga një shitës i autorizuar i lidhur me prodhuesin e makinave të vendosura në këtë sistem, qoftë në nivelin inxhinierik, por edhe në atë teknik i mesëm.

Plani i menaxhimit të mirëmbajtjes

Një plan menaxhimi mirëmbajtjeje i mirë përfshin analiza kostosh të sakta si dhe siguron që konforti i okupantëve të rëndësisë së veçantë, planifikimi i energjisë si dhe sistemet e mbrojtjes dhe sigurisë, të jenë optimale për të gjitha pajisjet.

Gjatë funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemit AC në KM duhet të përfshihen çështjet e mëposhtme:

- Efektshmëria e kostove
- Marrja në dorëzim e punimeve rutinë nga Autoriteti

- Rugët e menaxhimit të kohës së ekzekutimit të mirëmbajtjes të lidhur ngushtë me kohën e punës në zyra dhe mjedise të ndërtesës në raport me ndalimin e përkohshëm për efekt mirëmbajtjeje zonale të sistemit AC (korridore, kohë jashtë kohës së punës, fund jave, festa, etj).
- Mbajtja e dokumentacionit dhe e regjistrimeve të ndërhyrjeve mirëmbajtëse sipas protokolleve të përcaktuara në manualet e pajisjeve të prodhuesit.
- Ndarja e përgjegjësisë për shërbimet ndaj pajisjeve të ndara sipas thellësisë të ndërhyrjes. Kjo do të thotë se, në dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, duhet të identifikohen operacionet e punës që kryhen nga stafi i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve dhe operacione të cilat mund të kryhen nga staf teknik i trajnuar.

Ofertuesi fillimisht duhet të raportojnë/pranojnë se sistemet e reja të vendosura në funksion janë brenda parametrave projektues. Më pas, gjatë mirëmbajtjes është përgjegjësi e stafit të fituesit të mirëmbajtjes të ruajnë këto funksione projektuese gjatë gjithë jetëgjatësisë së sistemit dhe rrjedhimisht të ndërtesës.

Dokumentacioni për protokollat e mirëmbajtjes

Dokumentacioni për protokollat e funksionimit dhe mirëmbajtjes duhet të përpilohen në përputhje me “Manualat për funksionimin dhe mirëmbajtjen” që shoqëron çdo pajisje:

DAIKIN IV VRV	Sasia (njësi)
Njësi të brendshme incasso 5,6 -8,0 kW	21
Njësi të brendshme kanalore 7,1- 25,0 kW	32
Njësi të brendshme kasete 3,6-16,5 kW	216
Njësi të brendshme tokësore 2,8-8,0 kW	3
Njësi të jashtme VRV 13,4-63,0 kW	48
Rekuperator ajri	14

Informacioni lidhur me këto pajisje gjendet në dosjen e dorëzuar pas përfundimit të punimeve dhe vënies në punë të sistemit Daikin IV VRV dhe Toshiba VRV. Ofertuesit duhet të kenë një paketë të plotë të dokumentacionit të funksionimit dhe mirëmbajtjes konsiston në dokumentat e mëposhtëm:

Direktoria e dokumentave të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Kjo diretori duhet të sigurojë akses në dokumentacionet që përmbajnë informacione të ndryshme në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Gjithashtu ky informacion duhet të jetë i mirë organizuar dhe lehtësisht i identifikueshëm.

Informacionin në rast emergjencash. Informacioni në rast emergjencash duhet të jetë i disponueshëm në situata emergjente dhe duhet të përmbajë procedura emergjente si dhe staf përkatës.

Manualat funksionues. Manuali i funksionimit të sistemit të ndërtesës duhet të përmbajë:

- III. Informacion të përgjithshëm
 - a) Funksionin e ndërtesës
 - b) Përshkrimin e ndërtesës
 - c) Ditaret dhe standardet e punës
- IV. Informacioni teknik
 - a) Përshkrimi i sistemit
 - b) Procedurat rutine
 - c) Start-up dhe shut-down (nisjet dhe ndalimet) sezonale

- d) Procedurat speciale
- e) Defektet bazë

Manuali i mirëmbajtjes duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- III. Fletët e punës “as build” me të dhënat e pajisjeve
 - a) Të dhëna të përgjithshme
 - b) Garancinë
- IV. Informacione mbi programin e mirëmbajtjes
 - g) Të dhëna mbi instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen
 - h) Inventarizimin e pjesëve të ndërrimit
 - i) Veprimet mbrojtëse të mirëmbajtjes (kujdesin ndaj goditjeve elektrike)
 - j) Grafikun e ndërhyrjeve të mundshme
 - k) Përshkrimin e veprimeve ndërhyrëse
 - l) Historikun e ndërhyrjeve mirëmbajtëse

Proces-verbalet e testeve. Proces verbalet e testeve dokumentojnë performancën e vërtetuar gjatë start-up-eve si dhe bëjnë të mundur përpilimin e mbarëvajtjes së punës gjatë jetëgjatësisë së një pajisjeje.

Dokumentet ndërtimore. Në këtë dokumentacion duhet të përfshihen edhe kopje të dokumentave ndërtimore mbi të cilat është vendosur sistemi AC me përmasa të fletëve të punës. Të gjithë dokumentacionet e mësipërme duhet të jenë në dispozicion të çdo departamenti pajisjesh.

Menaxhimi i mirëmbajtjes

Me termin “Menaxhimi i mirëmbajtjes” kuptohet planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i veprimeve të mirëmbajtjes.

Tre tipet e programit të mirëmbajtjes që mund të adoptohen në ndërtesën e KM janë:

- 4) mirëmbajtje parashikuese – është mirëmbajtje e cila bazohet në monitorimin e pajisjeve dhe në tregues të gjendjes dhe performancës për të përcaktuar intervalet riparuese. Këtë situatë e parashikon sistemi IT i kontrollit me software të Daikin.
- 5) mirëmbajtje parandaluese – është rasti kur mirëmbajtja është plotësisht e programuar.
- 6) punë deri në avari – është rasti kur deri sa të japë defekt të rëndë dhe në këtë rast nuk shpenzohen para deri sa pajisja të krijojë avari e puna të ndërpritet.

Të tre këto grupe mirëmbajtjesh kanë nivele të ndryshme ndërhyrjeje, nga më të përciptat deri tek më të detajuarat. Kostot e mirëmbajtjes përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të kostos funksionuese të një pajisjeje, për këtë arsye menaxhimi sa më efektiv i mirëmbajtjes është mjaft i rëndësishëm.

Trajnimet dhe aftësitë e “Skuadrës së mirëmbajtjes”

Funksionimi dhe mirëmbajtja e sistemit të AC në ndërtesën e rëndësishme të veçantë të Kryeministrit, kërkojnë një staf me kombinimin e duhur të aftësive teknike dhe menaxheriale. Aftësitë teknike këtu nuk përfshijnë vetëm njohuritë mbi funksionimin dhe mirëmbajtjen mekanike por gjithashtu përfshijnë edhe njohuritë inxhinierike të vetë mekanikut që do të qëndrojnë pranë impiantit. Aftësitë menaxheriale përfshijnë menaxhimin e pajisjeve gjatë periudhës së jetëgjatësisë së saj si dhe menaxhimin ditor të pajisjes.

Vënia në punë dhe operimi i përditshëm është një nivel menaxhimi relativisht i ulët. **Ndërsa kontraktimi i kompanive mirëmbajtëse sigurojnë një nivel tjetër menaxhimi mirëmbajtje. Kjo është kërkuar për sistemin e AC në KM.**

Sistemet KOMPLEKSE të ndërtesës së KM

Ndërtesat e natyrës si Kryeministria, duke përfshirë këtu 48 impiante qendrore, kërkojnë një strukturë menaxheriale komplekse. Kjo ndërtesë ka nevojë për dy stafe të veçanta:

3. njëri staf është personeli i cili do të vinte në punë e do kujdesej çdo ditë për pajisjet e sistemin në tërësi dhe duhet të qëndrojë i gatshëm.
4. stafi tjetër do ishte ai i mirëmbajtjes më të thelluar dhe duhet të jetë i gatshëm sipas skedulit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në total kontraktori i mundshëm është përgjegjes direkt, qoftë për punët e përditshme (stafi në piken 1), qoftë për punë më të specializuara (stafi në pikën 2)

Buxheti për këto dy raste është preventivuar të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur, gjithashtu programet e kompjuterizuara të mirëmbajtjes, programe të cilat detajojnë në mënyrë të hollësishme intervalet e duhura të procedurave të mirëmbajtjes së sistemit në mënyrë që të gjithë sistemet të operojnë me efikasitet maksimale ndërsa ruajnë komfortin e okupantëve të ndërtesës. Në këtë kontekst, meqenëse çdo pajisje e vendosur në këtë ndërtesë është investim afatgjatë, çdo gjetje rreth këtyre kostove fillestare duhet të gërshetohet si me koston e jetëgjatësisë së kësaj pajisje dhe me aftësinë që ka kjo pajisje për të përmbushur kërkesat e komfortit të okupantëve, ndërsa është në vëmendje për të përdorur një bilanc të arsyeshëm energjie i cili do të auditohet.

Monitorimi i gjendjes së pajisjeve

Një aspekt i rëndësishëm i funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve inxhinierike AC të montuara dhe të vëna në punë në ndërtesën e KM është kontrolli ose vlerësimi i gjendjes së pajisjes. Për sistemet komplekse sikurse edhe në këtë ndërtesë historike, mund të jetë e nevojshme monitorimi njëherazi i disa kushteve ose gjendjeve të tilla si temperatura, vibrimet dhe ngarkesave në mënyrë që të bëhet një vlerësim i gjendjes së përgjithshme.

- Një nga praktikat më efektive të monitorimit të gjendjes së sistemit AC në ndërtesën e KM është kontrolli rutinë i funksionimit të impiantit i kryer nga një teknik gjatë kontrolleve të rregullta dhe plotësisht të skeduluara që planifikohen t'i bëhen impiantit gjatë regjimit ditor të tij. Njohuritë që mund të ketë ky teknik së bashku me eksperiencën dhe familjaritetin e tij me impiantin janë elemente të paçmueshëm në diagnostikimin e gjendjes së impiantit në fjalë.
- Parametrat apo gjendja fizike mund të maten në mënyrë objektive dhe në kohë reale duke përdorur pajisje speciale (metoda fizike) ose vetëm sensorët e përgjithshëm të sistemit menaxhues të ndërtesës përmes kompjuterit dhe programit kompjuterik të miratuar nga prodhuesi. Një parametër i gjendjes fizike të tillë, siç është vibrimi në gushinetat e elementeve rrotullues, mbushja me pluhur, sasia e limituar e ajrit, etj., janë elemente të cilat duhet të monitorohen dhe mirëmbahen në vend afër pajisjes. Të tjerat, si prodhimi i të ngrohtit, të ftohtit, temperatura, gjendja në punë apo jo, janë pjesë e programit kompjuterik

Në rastin e ndërtesës të KM nevojiten domosdo disa parametra për një problem të caktuar, për shembull, për të përcaktuar shkallën e ndotjes së filtrit të ajrit në një sistem VAV, pra me volum të ndryshueshëm të ajrit, është e nevojshme të matet presioni diferencial përgjatë filtrit dhe të interpretohet me pas në terma të rrymës aktuale që kalon përmes filtrit. Kjo mund të bëhet ose

duke e lënë të punojë ventilatorin në shpejtësinë maksimale dhe më pas të matet presioni diferencial ose duke kombinuar një sinjal të vlerës së rrymës me një sinjal të presionit diferencial. Këtë situatë duhet ta monitorojë automatikisht sistemi i kompjuterizuar.

Teknika të tjera monitoruese të parametrave të punës duhet të jenë:

- (5) përdorimi i imazheve termike infra të kuqe të lidhjeve elektrike për të përcaktuar nëse lidhjet mekanike janë të shtrënguara aq sa duhet apo jo,
- (6) analizimi i rrymës elektrike për të diagnostikuar problemet në bobinat e motorrit,
- (7) matja e presionit diferencial përgjatë hapësirës së filtrit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë për të përcaktuar intervalet optimale të pastrimit apo ndërrimit, pasi të jete dhënë sinjali se filtri është i ngarkuar me pluhura të ajrit?
- (8) matja e diferencës së temperaturës brenda dhe jashtë për një përgjigje sa më të saktë të ngarkesës termike të pompës së nxehtësisë.

KOSTOT E SISTEMIT TË MIRËMBAJTJES

Për të gjykuar mbi koston që do na marrë menaxhimi i një sistemi të caktuar të instaluar për mirëmbajtjen, duhet të fillojmë me kostot që shoqërojnë çdo projekt. Këto kosto janë tre dhe janë përkatësisht kostot e pronësisë, të funksionimit dhe kostot e mirëmbajtjes.

Kostot e pronësisë dhe jetëgjatësia

Elementët e mëposhtëm duhet të merren parasysh për të vlerësuar dhe llogaritur kostot vjetore të pronësisë:

- (1) kostot fillestare, për sa kohë jemi në kushtet kur këto kosto janë realizuar, nuk është e nevojshme të merremi me këtë situatë.
- (2) periudha e mirëmbajtjes.

Listat e detajuara të pajisjeve, materialeve, pajisjeve të kontrollit, kërkesa për hapësirë për vendosjen e pajisjeve, puna instaluese dhe kështu me rradhë, pra të gjitha këto elemente duhet të llogariten për të marrë një saktësi sa më të lartë në vlerësimin e kostove fillestare.

Tabela liston vlerësimet përkatëse të jetëgjatësisë së shërbimit të disa elementëve të një sistemi. Jetëgjatësia e shërbimit është koha gjatë të cilës një sistem i veçantë ose një përbërës i caktuar vazhdon të punojë sipas kushteve fillestare të zbatimit. Zëvendësimi i një sistemi ose i një komponenti të tij mund të jetë si pasojë e çdo faktori të tillë si defekte të ndryshme, vjetërsim, besueshmërisë së reduktuar, kosto të tepërta mirëmbajtje dhe si pasojë edhe të ndryshimit të kërkesave të sistemit si shkak i ndikimit të çmimit të ndryshuar të energjisë, konsideratave mjedisore ose të ndryshimit të kërkesave të sistemit. Periudha e amortizimit zakonisht vendoset nga ligjet e vendosura nga shteti.

Gjithsesi në këtë fazë është e domosdoshme të njihet periudha e jetëgjatësisë të pajisjeve të vendosura si me poshtë:

DAIKIN IV VRV	Sasia (njësi)	Jetëgjatësia (vite)
Njësi të brendshme incasso 5,6 -8,0 kW	21	15
Njësi të brendshme kanalore 7,1- 25,0 kW	32	15
Njësi të brendshme kasete 3,6-16,5 kW	216	15
Njësi të brendshme tokësore 2,8-8,0 kW	3	12
Njësi të jashtme VRV 13,4-63,0 kW	48	20

Njesi ftohje e dhomës së serverave	5	20
Rekuperator ajri	14	20

KOSTOT E MIRËMBAJTJES

Cilësia e mirëmbajtjes dhe kontrolli nga Autoriteti kontraktor i mirëmbajtjes janë faktorët kryesore në kostot energjitike të ndërtesës. Praktikën më të mira sjellin rreth 18.60⁵ \$/m² në vit për ndërtesat e mëdha mbi 6000 m² sipërfaqe operuese me chiller. Literatura parashikon se mosha e një ndërtese ka efektin e saj në këto kosto, por gjithsesi jo aq të rëndësishëm. Duke analizuar vendndodhjen gjeografike, të dhënat është konstatuar se edhe vendndodhja gjeografike nuk ka ndonjë ndikim të madh në kostot e mirëmbajtjes së një sistemi të kondicionimit të ajrit. Gjithsesi analiza për sisteme komplekse me VRV është një analizë që kërkon llogaritje sipas punës që do të kryhen në secilën pajisje. Si analizë paraprake mund të thuhet se ndërtesa e KM ka një shtrirje rreth 7,775 m² dhe kosto paraprake për mirëmbajtjen vjetore del afërsisht 15,700,000 All/vit. Duket se kjo kosto është e arsyeshme sepse është sa 3-6,5 % të kostove të ndërtimit të impiantit të plotë (total 179 mil ALL + 69 mil Serverat). Kjo normë në BE përbën të paktën mirëmbajtjen deri në amortizimin e plotë të pajisjeve referuar jetëgjatësisë të impiantit i cili është të paktën 15 vjet.

Ndikimi i zhvillimit të teknologjisë

Zhvillimi i teknologjisë si dhe përdorimi i refrixheranteve të ndryshëm, e ka ballafaquar vazhdimisht një sistem kondicionimi të jetë i kërcënuar nga këto zhvillime. Gjithsesi duhet të kihet parasysh disa faktorë:

- **Kostot Fillestare.** Pajisjet e reja mund të kenë kosto instaluese shumë më të mëdha se përshtatja e një pajisjeje ekzistuese. Për shembull, ndryshimi i një pajisjeje të jashtme ekzistuese me qëllim që të punojë me trup pune tjetër (p.sh. R-123) mund të kushtojë 50% të kostove që duhen për blerjen e një modeli të ri të kësaj pajisjeje.
- **Kostot e Funksionimit.** Eficenca e përgjithshme e pajisjeve të reja është zakonisht me e mirë se ajo e një pajisjeje të vjetër, ku kjo e fundit varet nga mosha, përdorimi, dhe niveli i mirëmbajtjes që është kryer gjatë jetëgjatësisë së pajisjes ekzistuese. Si rezultat mirëmbajtja është e domosdoshme të bëhet sepse, nëse nuk kryhet mund të reduktojë kapacitetin dhe eficientësinë.
- **Kostot e Mirëmbajtjes** për pajisjet e reja është zakonisht më e ulët se ajo e pajisjeve ekzistuese. Niveli i përshtatjes i kërkuar për të arritur kompatibilitetin shpesh përfshin zëvendësimin ose riprodhimin e pjesës më të madhe të komponenteve të një pajisjeje, gjë e cila do të çonte kostot e mirëmbajtjes dhe ato të riparimit në një nivel me kostot që mund të pritëshin nga pajisjet e reja.
- **Jetëgjatësia Produktive e Pajisjes** lidhet me përshtatjen e jetëgjatësisë produktive të një pajisjeje e cila përcaktohet nga shtrirja në kohë ose niveli i modifikimit të kërkuar përgjatë jetës së impiantit. Një zëvendësim i përgjithshëm ose një zëvendësim komplet i një pajisjeje do të zgjaste jetëgjatësinë produktive të mbetur në një nivel që mund të krahasohej me atë të një pajisjeje të re. Ky rast është kur teknologjia ofron nivele kursimi energjie të tilla të cilat sjellin kursime sa vete vlera e pajisjes, mirëmbajtja duhet të marrë një vendim për zëvendësimin

⁵ Ashrae 2019, <https://www.ashrae.org/technical-resources/ashrae-handbook/table-of-contents-2019-ashrae-handbook-hvac-applications>

Vendimet që lidhen me zëvendësimin e pajisjeve ekzistuese ose të shndërrimit në refrixherante me opsionale, ofrojnë mundësi për përmirësimin e efikasitetit të sistemit dhe duhen bërë së bashku me Autoritetin Kontraktor.

Sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe klimatizimit të ndërtesës së Kryeministrit në kontekstin e COVID-19

Ka shumë masa të mundshme që mund të merren për të zbutur rreziqet e transmetimit COVID-19 në ndërtesën e Kryeministrit gjatë vitit 2021.

Ky dokument përfshin rekomandimet për zgjidhjet e ventilimit si impianti kryesor që duhet kontrolluar në raport me ajrin e jashtëm. Duhet të kryhen “kontrollat e sasisë të ajrit të jashtëm” siç përshkruhet në hierarkinë tradicionale të kontrollit të infeksionit dhe për të zvogëluar rreziqet mjedisore të transmetimit përmes ajrit.

Sipas hierarkisë, ventilimi dhe masat e tjera të lidhura me sistemin AC&hidraulik janë në një nivel më të lartë sesa zbatimi i kontroleve administrative dhe pajisje mbrojtëse personale përfshirë maskat. Prandaj është shumë e rëndësishme të merren parasysh ventilimet dhe masat e tjera të sistemit të shërbimeve të ndërtimit për të mbrojtur nga transmetimi i ajrit. Këto mund të zbatohen në ndërtesat ekzistuese me një kosto relativisht të ulët për të zvogëluar rrezikun e infeksionit të brendshëm.

Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) ka përgatitur udhëzime për autoritetet e shëndetit publik në vendet e BE/EEA për ventilimin e hapësirave të brendshme në kontekstin e COVID-19. Ky udhëzim u drejtohet profesionistëve të shëndetit publik dhe shërben si bazë për të siguruar udhëzime teknike dhe specifike të sistemit për profesionistët e AC. Provat dhe konkluzionet kryesore nga ECDC mund të përmbledhen si më poshtë:

- i. Transmetimi i COVID-19 zakonisht ndodh në hapësira të mbyllura.
- ii. Aktualisht nuk ka prova të infeksionit njerëzor me SARS-CoV-2 të shkaktuar nga aerosolet infektive të shpërndara nëpër kanalet e ajrit të sistemit të ventilimit. Rreziku vlerësohet si shumë i ulët.
- iii. Sistemet e mirëmbajtura AC, duke përfshirë njësitë e kondicionimit të ajrit, filtrojnë në mënyrë të sigurt pikat e mëdha që përmbajnë SARS-CoV-2. Aerosolet COVID-19 (pikat e vogla dhe bërthamat e pikave) mund të përhapen përmes sistemeve AC brenda një pjese (zyrë) të ndërtesës dhe përmes njësive të pavarura të kondicionimit të ajrit nëse ajri riciklohet ose riqarkullon.
- iv. Rrjedha e ajrit e gjeneruar nga njësitë e kondicionimit të ajrit mund të lehtësojë përhapjen e pikave të sekretuara nga njerëzit e infektuar në distanca më të gjata brenda hapësirave të brendshme.
- v. Sistemet AC mund të kenë një rol plotësues në zvogëlimin e transmetimit në hapësirat e brendshme duke rritur shpejtësinë e ndryshimit të ajrit, duke zvogëluar riciklimin e ajrit dhe duke rritur përdorimin e ajrit të jashtëm.
- vi. Administrimi i sistemit të Kondicionimit që supozohet se përfshijnë sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe klimatizimit në përputhje me udhëzimet aktuale të prodhuesit, veçanërisht në lidhje me pastrimin dhe ndërrimin e filtrave është teper sensitiv dhe duhet respektuar sipas

termave të mirëmbajtjes. Nuk ka asnjë përfitim ose nevojë për cikle shtesë mirëmbajtjeje në lidhje me COVID-19.

- vii. Cilësimet e kursimit të energjisë, të tilla si ventilimi i kontrolluar nga kërkesa i kontrolluar nga një kohëmatës ose detektorë CO2, duhet të shmangen.
- viii. Duhet t'i kushtohet vëmendje zgjatjes së kohës së funksionimit të sistemeve HVAC para dhe pas periudhës së rregullt.
- ix. Rrjedha e drejtpërdrejtë e ajrit duhet të devijohet nga grupe individësh për të shmangur shpërndarjen e patogjenit nga subjektet e infektuara dhe transmetimin.
- x. Organizatorët dhe administratorët përgjegjës për mbledhjet dhe vendosjet kritike të infrastrukturës duhet të shqyrtojnë opsionet me ndihmën e ekipeve të tyre teknike/të mirëmbajtjes për të shmangur përdorimin e riqarkullimit të ajrit sa më shumë që të jetë e mundur. Ata duhet të marrin në konsideratë rishikimin e procedurave të tyre për përdorimin e riciklimit në sistemet HVAC bazuar në informacionin e siguruar nga prodhuesi ose, nëse nuk është i disponueshëm, duke kërkuar këshilla nga prodhuesi.
- xi. Numri minimal i shkëmbimeve ajrore në orë, duke ndjekur rregulloret në fuqi të ndërtimit, duhet të sigurohet në çdo kohë. Rritja e numrit të shkëmbimeve ajrore në orë do të zvogëlojë rrezikun e transmetimit në hapësira të mbyllura. Kjo mund të arrihet me anë të ventilimit natyror (hapja e dritareve) ose mekanik, varësisht nga vendosja.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne ambientet e Kryeministrise

Bazuar në pikën 5 të nenit 23 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për të gjitha specifikimet teknike të cilat i referohen markës “Daikin, Toshiba”, etj, në kushtet kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave në lidhje me specifikimet teknike të tyre, do të pranohen edhe ekuivalent i tij/saj.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁶

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

⁶ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

shtojca 14

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

